<p style="text-align: center;">Neni 17 Zgjidhja e skenarëve</p> <p>1. Zyrtarët policorë që kanë kaluar intervistën me gojë informohen për kohën, vendin dhe orarin e vlerësimit për zgjidhjen e skenarëve.</p> <p>2. Procesi i vlerësimit për zgjidhjen e skenarëve përfshinë por nuk kufizohet vetëm në: vlerësimet për menaxhimin e problemeve ditore; ushtrime për planifikim; aftësi për lidërsip; shkathtësi komunikimi; shkathtësi të vendimarrjes; shumëllojshmëria kulturore dhe vetëdijesimi i komunitetit; menaxhimi i ndryshimeve; menaxhimi i karrierës; shkathtësitë trajnuese (coaching).</p> <p>3. Në vlerësimin e zgjidhjes së problemeve që</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Solving the scenarios</p> <p>1. The police officers who passed the oral interview are notified about the time, date and location of evaluation for solving the scenarios.</p> <p>2. The process of evaluation for solving scenarios includes but it is not limited only in; exercises for managing daily issues, planning exercises, leadership skills, communication skills, decisionmaking skills, cultural diversity and community awareness, change management, career management; coaching skills.</p> <p>3. In problem solving evaluation related to</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Ocenjivanje rukovođenja</p> <p>1. Policijski službenici koji su položili pismeni test, biće obavešteni o mestu, vremenu i rasporedu ocenjivanja scenarija.</p> <p>2. Proces ocenjivanja scenarija obuhvata ali se ne ograničava na: vežbe za rukovođenje dnevnih problema, vežbe za planiranje, sposobnost za vodjstvo, komunicirajuće sposobnosti, veštinu donošenja odluke, kulturnu raznovrsnost i podizanje svesti zajednice, rukovođenje promenada, menadžiranje karijere , obučavajuće sposobnosti (coaching).</p> <p>3. U ocenjivanju rešavanja problema koji se</p>

<p>kanë të bëjnë me punë praktike, zyrtarit policor duhet t'i jepet situata me skenarë të ndryshëm dhe t'i tregohen parimet për të cilat do të vlerësohet.</p> <p>4. Skenari për zgjidhjen e problemeve i jepet zyrtarit policor me shkrim nga paneli vlerësues. Zyrtarit policor i lihet një kohë prej së paku 5 minutash për t'u përgatitur për situatën dhe për të filluar zgjidhjen e saj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Ankesa në proces të gradimit</p> <p>1. Çdo zyrtar policor ka të drejtë të parashtrojë ankesë.</p> <p>2. Të gjitha ankesat i parashtrohen Komisionit për procesin e gradimit dhe Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore.</p> <p>3. Procedura për parashtimin e ankesave.</p> <p>3.1. Pas çdo faze të testimit zyrtari policor ka të drejtë ankesë. Ankesat duhet të bëhen me shkrim dhe të drejtuara në çështje specifike dhe faktike.</p> <p>3.2. Në fazën e aplikimit, pas njoftimit të zyrtarit policor për statusin e tij në këtë proces, ankesa mund të bëhet personalisht, përmes shërbimit postar apo postës elektronike, brenda tre (3) ditë pune.</p>	<p>works in practice, the police officer shall be given situation with different scenarios and explained the principles for which the officers will be evaluated.</p> <p>4. The problem solving scenario is given to the police officer in written form by the assessment panel. The police officer is given 5 minutes time to prepare for the situation and to start solving it.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Appeals on the promotion process</p> <p>1. Every police officer has the right to appeal.</p> <p>2. All appeals are submitted to the Commission of promotion process and to the Director of Department of Human Resources.</p> <p>3. The procedure for submitting appeals</p> <p>3.1. After each testing stage the police officer has the right to appeal. The appeals shall be written and addressing in specific and factual issues.</p> <p>3.2. In application stage, after the notification of police officer for the his status in the process, the appeal may be done personally, via mailing services or electronic mail, within three (3) working days.</p>	<p>odenose na praktičan rad, policijskom službeniku biće data situacija sa raznim scenarijima i biće mu objašnjena pravila za koja će biti ocenjivan.</p> <p>4. Scenarijo za rešavanje problema predaje se pismenim putem policijskom službeniku od strane odbora za ocenjivanje. Policijskom službeniku se daje najmanje 5 minuta vremena kako bi se pripremio za situaciju i njeno rešavanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Žalba u procesu unapređenja</p> <p>1. Svaki policijski službenik ima pravo podneti žalbu.</p> <p>2. Sve žalbe podnose se Komisiji za proces unapređenja i Direktora Uprave za Ljudske Resurse.</p> <p>3. Procedura za podnošenje žalbi.</p> <p>3.1. Nakon svake faze testiranja policijskog službenika ima pravo na žalbu. Žalbe trebaju biti pismenog oblika i usmereni u specifičnim i činjeničkim pitanjima.</p> <p>3.2. U fazi primene, nakon obaveštenja policijskog službenika za njegovu situaciju u ovom procesu, žalba može se podneti lično, pomoću poštanske službe ili elektronske pošte, unutar tri (3) radna dana.</p>
--	--	---

<p>3.3. Testi me shkrim - Zyrtari policor menjëherë pas dorëzimit të testit me shkrim dhe para publikimit të rezultatit të testimit e ka të drejtën e ankesës.</p> <p>3.4. Intervista me gojë - Zyrtari policor menjëherë pas përfundimit të intervistimit me gojë dhe para publikimit të rezultatit të intervistimit e ka të drejtën e ankesës.</p> <p>3.5. Zgjidhja e problemit sipas skenarëve - Zyrtari policor para publikimit të rezultatit për zgjidhjen e problemit sipas skenarëve, ka të drejtën e ankesës</p> <p>4. Me pranimin e ankesës, Komisioni dhe Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore duhet të shqyrtojë ankesat dhe të marrin vendim në afatin kohor brenda 24 orëve.</p> <p>5. Ankesat e parashtruara nuk e shtyjnë procesin e gradimit dhe promovimin e të graduarve.</p>	<p>3.3. Written test – the police officer immediately after submitting the written test and before the testing results are published has the right to appeal.</p> <p>3.4. Oral interview – the police officer immediately after completing the oral interview and before the oral interview results are published, has the right to appeal.</p> <p>3.5. Problem solving scenarios - the police officer before the results for problem solving scenarios are published, has the right to appeal.</p> <p>4. By receiving the appeal, Commission and Director of Department for Human Resources shall review the appeals and make the decision in within 24 hours.</p> <p>5. Submitted complaints will not postpone the ranking process and promotion of the ranked officers.</p>	<p>3.3. Pismeni test- Policijski službenik odmah nakon predaje pismenog testa i pre objavljivanja rezultata ima pravo na žalbu.</p> <p>3.4. Usmeni intervju- Policijski službenik odmah nakon završetka usmenog intervjua i pre objavljivanja rezultata intervjuisanja ima pravo na žalbu.</p> <p>3.5. Rešavanje problema putem scenarija - Policijski službenik pre objavljivanja rezultata rešavanje problema putem scenarija ima pravo na žalbu.</p> <p>4. Prijemom žalbe, Komisija i Direktor Uprave za Ljudske Resurse trebaju razmatrati žalbe i donositi odluku u vremenskom roku unutar 24 sata.</p> <p>5. Podnošene žalbe ne odugovlače proces unapređenja i promovisanje unapređenih osoba.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19</p> <p>Nxjerrja e rezultateve dhe komunikimi i tyre</p> <p>1. Testi me shkrim në të gjitha rastet kontrollohet në mënyrë elektronike apo fizike menjëherë pas përfundimit të testit.</p> <p>2. Nëse zyrtari policor nuk ka plotësuar të dhënat individuale si dhe të dhënat e kërkuara</p>	<p style="text-align: center;">Article 19</p> <p>Scoring and publishing the score</p> <p>1. Written test in all cases is checked in electronic or physical way immediately after completion of the exam.</p> <p>2. If the police officer did not fill out the individual information and other information</p>	<p style="text-align: center;">Član 19</p> <p>Izvođenje rezultata i njihove komunikacije</p> <p>1. Pismeni test u svim slučajevima proveravaju se na elektronski ili fizički način odmah nakon završetka testa.</p> <p>2. Ako policijski službenik nije potpuno pojedinačne podatke kao i zahtevane podatke u</p>

<p>në fletë përgjigjen e testit sipas udhëzimeve, vlerësohet me zero pikë.</p> <p>3. Nëse zyrtari policor nuk ka plotësuar përgjigjen sipas udhëzimeve të dhëna, pavarësisht përgjigjes së tij, ai nuk do të rivlerësohet për përgjigje.</p> <p>4. Rezultatet e testit me shkrim publikohen në vend të dukshëm, menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve.</p> <p>5. Në çdo rast pas përfundimit të testimit për intervistën me gojë dhe zgjidhjen e problemit sipas skenarëve, paneli vlerësues duhet të përfundojë vlerësimin e zyrtarit policor dhe fletë vlerësimin ia dorëzon personit përgjegjës për administrim të procesit, para se të vazhdojë vlerësimi për zyrtarin policor pasardhës.</p> <p>6. Rezultatet e intervistës me gojë dhe zgjidhja e problemit sipas skenarëve i komunikohen zyrtarit policor me shkrim brenda dy ditë pune nga përfundimi i testimit përkatës.</p> <p>7. Publikimi i listës përfundimtare për të gjitha fazat do të bëhet në mënyrën siç është paraparë në nenin 13, paragrafi 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p>8. Për të plotësuar strukturën komanduese dhe ngritjen e baraspeshës etnike në shërbim,</p>	<p>required in answer sheet according to the instructions, he is evaluated with zero points.</p> <p>3. If the police officer did not give the answer according to instructions given, regardless of his answer, he will not be rescored for the answer.</p> <p>4. The written test result is published in a visible place, immediately after scoring.</p> <p>5. In all cases after completion of oral interview and problem solving scenario, assessment panel shall complete the assessment of the police officer and hand over the assessment sheet to the responsible person for administering the process, prior to start the assessment of the next police officer.</p> <p>6. The results of the oral interview and problem solving scenario are communicated to the police officer in write form within two working days from completion of the related test.</p> <p>7. The announcement of final list for all stages will be done in manner as stated in article 13, paragraph 3 of this administrative instruction.</p> <p>8. In order to complete the commanding structure and increase of ethnical balance in the</p>	<p>listu odgovora testa prema uputstvima, procenjuje se sa nula poena.</p> <p>3. Ako policijski službenik nije potpunio odgovor prema datim uputstvima, bez obzira na njegov odgovor, to se neće ponovo oceniti za odgovor.</p> <p>4. Rezultati pismenog testa objavljuju se u vidljivom mestu, odmah nakon izvođenja rezultata.</p> <p>5. U svaki slučaj nako završetka testa za usmeno intervjuisanje i rešavanja problema putem scenarija, odbor procenjivača treba završiti procenu policijskog službenika i listu procena predaje odgovornoj osobi za administriranje procesa, pre nastavljanja procene za narednog policijskog službenika.</p> <p>6. Rezultati usmenog intervjua i procene rešavanja problema putem scenarija se pismeno policijskom zvaničniku unutar dva dana od završetka određenog testiranja.</p> <p>7. Objava završne liste za sve faze izvršit će se onako kako je predviđeno članom 13, stav 3 ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p>8. Da bi popunio komandnu strukturu i povećali etničku ravnopravnost u službi, Policija Kosova</p>
---	---	--

<p>Policia e Kosovës përcakton kriteret e veçanta të gradimit të pjesëtarëve të vet më të aftë profesionalisht në gradën: Rreshter, Toger dhe Kapiten.</p> <p>9. Kjo bëhet me qëllim të plotësimit të pozitive mbikëqyrëse dhe udhëheqëse nga radhët e komuniteteve jo shumicë në territore të caktuara vetëm në rastet kur mungon procesi i rregullt i gradimeve.</p> <p>10. Gradimi në gradat siç parashihet në paragrafin 8 të këtij neni bëhet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Kosovës.</p> <p>11. Kriteret e veçanta të gradimit përcaktohen me PSO të Drejtorisë për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës.</p>	<p>service the Kosovo Police determines the special criteria of promotion of its most professionally skilful member with the rank: Sergeant, Lieutenant and Captain.</p> <p>9. This is done in order to complete the supervision and leadership positions among non-majority communities in certain territories only in cases when there is lack of the regular promotion process.</p> <p>10. Promotion in ranks as foreseen in the paragraph 8 of this article is done by the decision of the General Police Director.</p> <p>11. The special criteria of promotion are determined by the SOP of the Directorate of Performance and Career Development.</p>	<p>utvrđuje posebne kriterijume unapredjenja svojih profesionalno najsposobnijih svojih pripadnika u činu vodnika, poručnika i kapetana.</p> <p>9. Ovo se uradi u cilju popunjavanja nadzornih i rukovodećih položaja iz redova zajednice manjine, u odredjenim teritorijama samo u slučajevima kada izostane redovni proces unapredjenja.</p> <p>10. Unapredjenja u činovima kao što se predvidja stavom 8 ovog člana vrši se odlukom Generalnog Direktora Policije Kosova</p> <p>11. Posebni kriterijumi unapredjenja odredjuju se OSP-om Direkcije za razvoj performanse i karijere.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Dhënia e gradës dhe caktimi në detyrë</p> <p>1. Pas përfundimit me sukses të trajnimit për gradën përkatëse, zyrtarëve policorë i'u jepet grada përkatëse dhe caktohet në detyrë në përputhje me gradën e fituar.</p> <p>2. Të gjithë kandidatëve me gradë të re do t'u caktohet Statusi Provues për gjashtë muaj, gjatë së cilës kohë zyrtari policor do të vlerësohet për performancën e tij/saj në gradën e re.</p> <p>3. Pas tre muajve, kandidati do të vlerësohet</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Promotion and assignment on duty</p> <p>1. After succesful completion of training for the respective rank, the police officer is promoted to the respective rank and assigned on duty in compliance with the rank gained.</p> <p>2. All new promoted candidates will be given the Probation Status for six months, during which time the police officer will be evaluated for his/her performance in the new grade.</p> <p>3. After three months, the candidate will be</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Unapredenje i određivanje zadatka</p> <p>1. Nakon uspešnog završetka obuke za određeni čin policijskim zvaničnicima dati određeni čin i odrediti zadatak u skladu s dobijenim činom.</p> <p>2. Svim kandidatima novim činom određice im se probni status za šest meseci za koje vreme policijski službenik će se oceniti za njegovu/njenu performansu u novom činu.</p> <p>3. Nakon tromesečja , kandidat će se ocenjivati</p>



<p>nga mbikëqyrësi i tij/saj i parë. Kandidati do të njoftohet për rezultatet e vlerësimit dhe do t'i jepen tre muaj për të përmirësuar ndonjë mangësi të identifikuar që është paraqitur gjatë performimit të tij/saj.</p> <p>4. Pas përfundimit të punës provuese prej gjashtë muajve, kandidati do t'i nënshtrohet vlerësimit të dytë. Në këtë fazë kandidatit duhet t'i caktohet detyra e përhershme për gradën e re ose i njëjti duhet të rikthehet në gradën e mëparshme.</p> <p>5. Nëse kandidati nuk aprovohet për caktim të përhershëm në gradën e re rikthehet në gradën e mëparshme, ai/ajo nuk mund të aplikoj për avancim/gradim në periudhën vijuese prej një (1) viti.</p> <p>6. Çfarëdo kohe brenda gjashtë muajve të periudhës provuese, Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë diskrecionale me arsye ta largoj kandidatin dhe ta rikthej në gradën paraprake.</p> <p>7. Prioriteti për gradim në pozitë të lirë të hapur bazohet në nevojat operative të Policisë së Kosovës. Sistemimi apo caktimi në detyrë i të posa graduarve bëhet sipas nenit 42 të udhëzimit administrativ nr. 07/2012 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.</p> <p>8. Dhënia e gradës dhe caktimi në detyrë për</p>	<p>evaluated by his/her superior. The candidate will be notified for the results of evaluation and will be given three months to improve any identified deficiency during his/her performance.</p> <p>4. After completing the probation period of six months, the candidate will be subject of the second evaluation. In this phase the candidate will be appointed to the permanent duty in the new rank or the same must return to the previous rank.</p> <p>5. If the candidate is not approved to be appointed in the permanent rank he is returned to the previous rank, he/she cannot apply for an advance/promotion in the following period of one (1) year.</p> <p>6. Any time within six months of the probation period. The general director has the discretionary right with any reason to remove the candidate and turn him back to the previous grade.</p> <p>7. The priority for promotion to a vacant position is based on the operational needs of the Kosovo Police. Systematization and appointment in duty of newly promoted officers will be done according to article 42 of administrative instruction on working relation in Kosovo Police.</p> <p>8. Promotion to the rank and assignment of duty</p>	<p>od strane svog prvog nadzornika. Kandidat će se upoznati o rezultatima ocenjivanja i daje mu se još tri meseci za otklanjanje nekih identifikovanih nedostataka koji se pojavio prilikom njegove/njene performanse.</p> <p>4. Nakon okončanja probnog rada od šest meseci, kandidat podvrgnut će se drugog ocenjivanja. U ovoj fazi kandidatu treba da se odredi stalna dužnost za novi čin ili će isti vratiti na predhodni čin.</p> <p>5. ukoliko se kandidat ne odredjuje za stalno odredjivanje u novom činu, vraća se u predhodnom činu, on/ona ne može da aplicira za unapredjenje u periodu od godinu dana.</p> <p>6. U bilo koje vreme u toku od šest meseci probnog rada, GD (generalni Direktor) ima diskrecionalno obrazloženo pravo da udaljava kandidata i da ponovo vraća u predhodni čin.</p> <p>7. Prednost unapredjenja u čin za slobodno mesto osniva se na operative potrebe Policije Kosova. Sistemizacija i imenovanje u službi novo gradiranih biće u skladu sa članom 42 administrativnog upustva o radnom odnosu u Policju Kosova.</p> <p>8. Unapređenje i određivanje zadatka za čin</p>
--	--	--

<p>gradën e nënkolonel dhe kolonel bëhet në bazë të rezultatit meritor të treguar në intervistën ekzekutive.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Administrimi i procesit</p> <p>1. Administrimin e procesit të promovimit e bën Drejtoria për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Zhvillim të Përformancës dhe Karrierës për administrimin e procesit me detajisht do të rregullohen me procedurë standarde të operimit për gradim.</p>	<p>for rank of lieutenant/colonel and colonel is based on the merit results achieved in executive interview.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Administration of process</p> <p>1. The administration of process is done by the Directorate of Performance and Carrier Development.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Directorate of Performance and Carrier Development to administer the process will be regulated in details by standard operational procedures for promotion.</p>	<p>potpukovnik i pukovnik se vrši na osnovu zaslužnog pokazanog rezultata u izvršnom intervju.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Administracija procesa</p> <p>1. Administracija procesa promovisanja vrši Direkcija razvoj performanse i karijere.</p> <p>2. Zadaci i odgovornosti Direkcije za razvoj performanse i karijere za rukovođenje procesa detaljnije će se regulisati sa standardnom procedurom operiranja za unapređenje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 22 Hartimi i pyetjeve dhe siguria e testeve</p> <p>1. Drejtoria për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës është përgjegjëse për përgatitjen e pakos së pyetjeve dhe skenarëve për të gjitha fazat e testimit nga e cila pako përzgjidhet një numër i caktuar i pyetjeve dhe skenarëve për secilën fazë të testimit.</p> <p>2. Komisioni për procesin e gradimeve do ta bëjë përzgjedhjen e pyetjeve dhe skenarëve për secilën fazë nga baza e të dhënave të pyetjeve dhe skenarëve të përgatitura nga Drejtoria për Zhvillim të Përformancës dhe Karrierës, siç parashihet me nenin 4, paragrafi 8 të këtij</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Compiling the questions and security of tests</p> <p>1. Directorate of Performance and Carrier Development is responsible to prepare the package of questions and scenarios for all stages of testing, from which package a certain number of questions and scenarios is selected for each stage of testing.</p> <p>2. The commission for the promotion process will select the questions and scenarios for each stage from the database of questions and scenarios prepared by Directorate of Performance and Carrier Development as stated in article 4, paragraph 8 of this administrative</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Sastavljanje pitanja i bezbednost testova</p> <p>1. Direkcija za razvoj performanse i karijere je odgovorna za pripremu kompleta pitanja i scenarija za sve faze testiranja sa koje se odabire jedan određeni broj pitanja i scenarija za svaku fazu testiranja.</p> <p>2. Komisija za proces unapređenja vrši odabir pitanja i scenarija za svaku fazu iz kompleta pitanja i scenarija pripremljene od strane Direkcije za razvoj performanse i karijere kao što je predviđeno članom 4, stav 8 ovog Administrativnog Uputstva.</p>

<p>udhëzimi administrativ.</p> <p>3. Pyetjet dhe skenarët përgatiten në disa variante për të njëjtën gradë dhe në çdo rast të ndryshme nga njëra gradë në gradën tjetër.</p> <p>4. Të gjitha pyetjet dhe skenarët e testimit të parapara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni duhet të mbahen të sigurta për të ruajtur integritetin e procesit.</p> <p>5. Materialet e testimit duhet të mbahen të mbyllura për periudhën që nuk përdoren, ruajtja, kontrolla dhe qasja në materialin e testimit rregullohet me procedura standarde të operimit.</p> <p>6. Siguria e materialeve dhe asgjësimi i materialit të pa nevojshëm me hollësisht do të rregullohet me akt të brendshëm i cili rregullon detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e punës së komisionit për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Analiza e procesit të gradimit</p> <p>1. Në përfundim të çdo procesi të gradimit do të bëhet një analizë nga Departamenti për Burime Njerëzore.</p> <p>2. Në analizë marrin pjesë të gjithë punonjësit që kanë marrë pjesë në përgatitjen, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit të gradimit</p>	<p>instruction.</p> <p>3. Questions and scenarios are prepared in several variants for the same rank and in every case are different from one rank to another rank.</p> <p>4. All questions and scenarios of testing as stated in paragraph 1 and 2 of this article shall be kept secured to ensure the intergity of the process.</p> <p>5. Testing materials shall be kept locked for the time that are not used, protection, control and access to the testing material is regulated by standard operational procedures.</p> <p>6. Security of materials and erasure of unnecessary material will be regulated in details by an internal act that regulates duties, responsibilities and the working procedures of the commission for supervision of the promotion process.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Promotional process analysis</p> <p>1. At the end of each promotional process an analysis will be conducted by the Department of Human Resources.</p> <p>2. All employees who participated in preparation, management and supervision of the promotional process will participate in the</p>	<p>3. Pitanja i scenariji se pripremaju u nekoliko varijanti za isti čin, i u svakoj prilici razne od čina do činu.</p> <p>4. Sva pitanja i scenarija predviđena u stavu 1 i 2 ovog člana treba sačuvati na bezbedno mesto s ciljem sačuvanja integriteta procesa.</p> <p>5. Materijale testiranja treba držati zatvorena u vremenu kada se ne upotrebljavaju, sačuvanje, kontrola i pristup materijalu testiranja se reguliše sa standardnim procedurama operiranja.</p> <p>6. Bezbednost materijala i uništavanje nepotrebno materijala detaljnije će se regulisati s unutrašnjim aktom koji reguliše zadatke, odgovornosti i radne procedure komisije za nadziranje procesa unapređenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Analiza procesa unapređenja</p> <p>1. Na kraju svakog unapređenja, vrši se analiza od strane Uprave za Ljudske Resurse.</p> <p>2. U analizi učestvuju svi radnici koji su aktivno učestvovali u pripremi, rukovođenju i nadgledanju procesa unapređenja.</p>
---	--	---

<p>3. Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore do të përgatit një raport përfundimtar për Drejtorin e Përgjithshëm. Në këtë raport përfshihet një plan i veprimit me rekomandimet për afatet kohore të caktuara për përmirësimin e mangësive të identifikuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Kriteret e uljes në gradë</p> <p>1. Të gjithë të graduarit në Policinë e Kosovës të cilët janë të emëruar në pozita menaxheriale i nënshtrohen procesit të vlerësimit menaxherial.</p> <p>2. Ulja në gradë mund të aplikohet në të gjitha rastet kur paraprakisht janë përcaktuar me plan objektivat dhe detyrat të cilat kërkojnë realizimin e tyre me sukses nga menaxherët e të gjitha niveleve.</p> <p>3. Vlerësimin duhet t'i paraprijnë edhe analizat periodike lidhur me përmbushjen e objektivave dhe detyrave të përcaktuara me plan.</p> <p>4. Me rastin e identifikimit të mangësive nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave dhe detyrave duhet të paralajmërohet me shkrim menaxheri se janë vërejtur dhe evidentuar mangësi –lëshime në punë menaxheriale të cilat duhet të</p>	<p>analysis.</p> <p>3. The Director of Department for Human Resources will prepare the final report for the General Director. Included in this report will be an action plan along with recommendations for the timeframes in correcting the identified deficiencies.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Rank reduction criteria</p> <p>1. Everyone promoted in Kosovo police who is appointed in a managing position is submitted to the managerial evaluation process.</p> <p>2. The managerial rank procedure can be applied in all cases when previously determined by a plan, objectives and duties which require their successful implementation by managers of all levels.</p> <p>3. Evaluation must be preceded by periodical analysis related to the fulfillment of objectives and duties determined by the plan.</p> <p>4. In case of identification of deficiencies by the direct superior in completing the objectives and duties the manager must be notified in written that there were noticed and evidenced deficiencies in the managerial work which must be corrected within an optimal period.</p>	<p>3. Direktor Uprave Ljudskih Resursa, priprema jedan konačni analitički izveštaj za Generalnog Direktora, izveštaj koji obuhvata i plan postupka sa preporukama za određene vremenske rokove za poboljšanje identifikovanih nedostataka.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Kriterijumi degradacije</p> <p>1. Svi unapredjeni u Policiji Kosova koji su imenovani u menadžerskim položajima, podvrgavaju se procesu menadžerskog ocenjivanja.</p> <p>2. Menadžerska degradacija može se aplicirati u svim slučajevima kada su predhodno odredile planom objektivni i dužnosti koje zahtevaju njihovo uspešno ostvarivanje od strane menadžera svih nivoa.</p> <p>3. Ocenjivanju treba predhoditi i periodične analize u vezi ispunjavanja objektivni i dužnosti utvrdjeni planom.</p> <p>4. Prilikom identifikacije nedostataka od strane neposrednih nadzornika na ispunjenju objektivni i dužnosti treba da se pismeno obavesti menadžer da su se primetile i evidentirane nedostatke-propusti u menadžerijalnom radu koje treba da se poprave u optimalnom roku.</p>
--	--	---

<p>përmirësohen brenda një afati optimal.</p> <p>5. Menaxheri i cili në vlerësimin final vlerësohet me notë të dobët (1-2) në fushat e vlerësimit që kanë të bëjnë me performimin personal dhe të organizatës mund të jetë subjekt i uljes së gradës.</p> <p>6. Propozimin për ulje në gradë mund ta jap komisioni profesional i formuar posaçërisht nga Drejtori i Përgjithshëm. Anëtarët e komisionit duhet të jenë zyrtarë me një gradë më të lartë se zyrtari i cili është subjekt i procesit të uljes së gradës.</p> <p>7. Komisioni pas analizës dhe vlerësimit për mos përmbushjen e objektivave dhe detyrave të planifikuara, i jep rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm për ulje për një gradë më të ulët për zyrtarin përkatës.</p> <p>8. Vendimin final për ulje të gradës e merr Drejtori i Përgjithshëm.</p> <p>9. Ndaj vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm pala e pakënaqur mund të ushtron ankesën në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime.</p> <p>10. Zyrtari i ulur në gradë mund t'i nënshtrohet procesit të rregullt të gradimit siç e përcaktojnë procedurat e këtij udhëzimi, pas dy viteve të plota nga momenti i uljes së gradës.</p>	<p>5. The manager who in the final evaluation is evaluated with an insufficient mark (1-2) in the fields of evaluations related to the personal performance and that of the organization, may be subject of rank reduction.</p> <p>6. The proposal for rank reduction may be given by the professional committee especially created by the General Director. Members of the committee must be officers with a higher rank than the officer who is subject of the rank reduction.</p> <p>7. The committee, after the analysis of the evaluation for not fulfilling the planned objectives and duties, recommends the General Director to reduce the rank in a lower one for the respective officer.</p> <p>8. The final decision for rank reduction is made by the General Director.</p> <p>9. Dissatisfied party may appeal against the decision of the General Director in the committee of Appeals and Awards.</p> <p>10. The officer who is a subject of rank reduction must be subjected to the regular promotion process as determined by the procedures of this instruction, after two full years from the moment of rank reduction.</p>	<p>5. Menadžer koji u konačnom ocenjivanju ocenjuje se slabom ocenom (1-2) u poljama ocenjivanja koje se odnose na ličnu performansu i performansu organizacije može biti subjekt degradacije.</p> <p>6. Predlog za degradaciju može dati stručna komisija posebno osnovan od strane Generalnog Direktora. Članovi komisije treba da su službenici za jedan činom više od službenika koji je subjekt degradacije.</p> <p>7. Komisija nakon analiziranja i ocenjivanja za neispunjavanje planiranih objekta i zadataka daje preporuku Generalnom Direktoru za degradaciju za jedan čin manje za dotičnog službenika.</p> <p>8. Konačnu odluku za degradaciju donosi Generalni Direktor.</p> <p>9. Protiv odluke Generalnog Direktora nezadovoljna stranka može podneti žalbu u Komisiji za Žalbe i nagradjivanje.</p> <p>10. Degradirani službenik može se podvrgavati redovnom procesu degradacije kako utvrđuju procedure ovog uputstva, nakon dve punih godina od momenta degradacije.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 25 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet udhëzimi administrativ nr.11/2009 për procedurat e gradimit për zyrtarët policorë</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Hyrja në fuqi dhe zbatimi</p> <p>1. Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë.</p> <p>2. Zbatimi i këtij udhëzimi administrativ fillon me aprovimin e të gjitha akteve nënligjore të domosdoshme për procesin.</p> <p style="text-align: center;">Shpend Maxhuni</p>  <p style="text-align: center;">Drejtor i Përgjithshëm i Policisë</p> <p>Gusht 2012 (I-ndryshuar me 08 shkurt 2013)</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Abrogation provisions</p> <p>By entering into force of this administrative instruction, administrative instruction nr. 11/2009 for promotion procedure for police officers, is abrogated.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Entry into force and implementation</p> <p>1. This Administrative Instruction shall enter into force on the day of signature by the General Director of Police.</p> <p>2. The implementation of this administrative instruction begins with the approval of all sublegal acts necessary for the process.</p> <p style="text-align: center;">Shpend Maxhuni</p>  <p style="text-align: center;">General Director of Police</p> <p>August 2012 (modified February 8, 2013)</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Nevažeće odredbe</p> <p>Stupanjem na snagu ovog Administrativnog Uputstva, ostavlja van snage administrativno uputstvo 11/2009 za procedure unapredjenja službenika policije</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Stupanje na snagu</p> <p>1. Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu dana potpisivanja od strane Generalnog Direktora Polcije Kosova.</p> <p>2. Sprovođenje ovog administrativnog uputstva počinje od usvajanja shih podzakonskih akata i obaveznih procedura za proces.</p> <p style="text-align: center;">Špend Madjuni</p>  <p style="text-align: center;">Generalni Direktor Policije</p> <p>Avgust 2012 (Izmenjen 08 februara 2013)</p>
---	---	--

Faza	Përshkrimi i procesit	Njësia/ Struktura	Autoriteti përgjegjës për zbatimin
<i>Hartimi i Listës së pozitive të lira për gradim nga Drejtori i Departamentit për Burime Njerezore.</i>	Brenda çdo viti, hartohet një listë e vendeve të lira (gradave përkatëse) bazuar mbi numrin e parashikuar të funksioneve të reja apo nevojave të mundshme të riorganizimit, qarkullimit të përgjithshëm të burimeve njerëzore dhe daljeve në pension të planifikuara për periudhën e ardhshme.	<i>Drejtoria e Përgjithshme – Burimet Njerezore</i>	Drejtori i Personelit
<i>Përshkrimi i detyrave për vendet e lira</i>	Kriteret për vendet e lira janë vjetërsia në gradë, vlerësime pozitive të punës, arsimimi dhe trajnimi.	<i>Drejtoria e Përgjithshme– Burimet Njerezore</i>	Zyrtari i Personelit
<i>Procedurat e ngritjes në gradë</i>	Kur krijohen vende të lira, është e nevojshme të përcaktohen hollësitë e procedurave të ngritjes në gradë si psh: lloji i gradës, koha dhe vendi i testimit, strukturat përgjegjëse, etj.	<i>Drejtoria e Përgjithshme– Burimet Njerezore</i>	Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierës
<i>Shpallja e konkursit për vendet e lira dhe mbledhja e aplikimeve</i>	Konkursi shpallet në një faqe të veçantë në rrjetin e brendshëm ose me anë të një njoftimi zyrtar. Kjo faqe mund të jetë edhe pjesë e aplikimit prej punonjësve të interesuar, e cila shërben si bazë për grumbullimin e këtyre aplikimeve nga struktura qendrore e personelit.	<i>Drejtoria e Përgjithshme– Burimet Njerezore</i>	Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierës
<i>Shqyrtimi i aplikimeve</i>	Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierës dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale shqyrtojnë aplikimet e zyrtareve policore dhe nëse ata nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara, nuk i përfshijn në listën e zyrtareve policore që do të testohen për ngritje në gradë. Zyrtareve policore të diskualifikuar u komunikohet arsyeja e mospërfshirjes në listë.	<i>Drejtoria e Përgjithshme– Burimet Njerezore</i>	Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierës dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale
<i>Përgatitja dhe zhvillimi i testeve</i>	Përgatitja e testeve bëhet nga Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierës dhe të aprovuara nga Drejtori i Përgjithshëm, ndërsa procedurat organizative të zhvillimit të testimit mbulojnë nga Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierës. Testimi zhvillohet në vendin dhe kohën e caktuar.	<i>Drejtoria e Përgjithshme</i>	Drejtoria e për zhvillim të performancës dhe karrierës
<i>Kandidatat e suksesshëm</i>	Pas përfundimit të testimit, mbi bazën e vlerësimeve hartohet lista për çdo kandidat në rend zbritës.	<i>Komisioni e mbikqyrw procesin</i>	Drejtoria e për zhvillim të performancës dhe karrierës
<i>Trajnimi i kandidatëve dhe ngritja në gradë</i>	Kandidatët e suksesshëm duhet të ndjekin trajnimin përkatës sipas listës me rend zbritës. Pasi të përfundojnë trajnimin me sukses, ata caktohen në detyrë sipas pozitive. Në rastet e mosngritjes në gradë, këta qëndrojnë në detyrën aktuale dhe kanë të drejtë të rikonkurojnë pas një viti.	<i>AKSP - Drejtoria e Personelit</i>	AKSP - Departamenti i Trajnimeve
<i>Administrimi i rezultateve të testimit</i>	Rezultatet e testit futen në bazën e të dhënave të Drejtorisë për zhvillim të performancës dhe karrierë për gradimet dhe veprimtaritë në lidhje me to.	<i>Drejtoria për zhvillim të performancës dhe karrierë</i>	Drejtoria e për zhvillim të performancës dhe karrierës

Event/Step	Description of Process	Unit/Instance	Agent Responsible for Execution
Preparing the list of vacancies for promotion by Director of Department for Human Resources	Each year a list of vacancies (respective ranks) is prepared based on the estimated number of vacancies or potential reorganization requirements, overall resource turnover and planned retirements for the coming period.	The General Directorate- Human Resources	Director of Personnel
Job descriptions of vacancies	The qualifications for the vacancies are: time in rank, positive performance evaluations, education and training.	The General Directorate- Human Resources	Personnel official
Promotion Procedures	When vacancies are created, it is necessary to define the details of the promotion procedures such as: type of rank, date and location of testing, responsible structures, etc.	The General Directorate- Human Resources	Directorate of Performance and Carrier Development
Publishing of vacancies and collecting applications	The vacancies are published on a special web site on the intranet or through an official advertisement. This site may even be part of the application for the interested employee, and it serves as a basis for collecting these applications by the central personnel structure.	The General Directorate- Human Resources	Directorate of Performance and Carrier Development
Review of applications	Directorate of Performance and Carrier Development and the Directorate of Professional Standards reviews the applications of Police officers and if they fail to meet the established qualifications, does not include them in the list of police officers to be tested for promotion. Disqualified officers shall be notified on the reasons of disqualification.	The General Directorate- Human Resources	Directorate of Performance and Carrier Development and Directorate of Professional Standards
Preparing and Conducting Tests	Preparation of tests is performed by Directorate of performance and carrier development and approved by the General Director, whereas the organizational procedures of the testing are covered by the Directorate of Performance and Carrier Development. Tests are conducted at the determined place and time.	The General Directorate	Directorate of Performance and Carrier Development
Successful candidates	After the testing is conducted, based on the assessments, an eligibility list is prepared in descending order.	Oversight Commission	Directorate of Performance and Carrier Development
Training candidates and promotion to rank	The successful candidates must attend the respective training according to descending order. After having completed the training successfully, they are appointed to duty based on the number of vacancies. In case of non-promotion, they stay in their current position and enjoy the right to re-compete after one year.	KAPS - Directorate of Personnel	KAPS - Training Department
Administration of Tests Results	Tests results are entered into the personnel database of Directorate of Performance and Carrier Development for promotions and related activities.	<i>Directorate of Performance and Carrier Development</i>	Directorate of Performance and Carrier Development

Faza	Opis procesa	Jedinica/Struktura	Odgovorni autoriteti za primenjivanje
Nacr liste slobodnih pozicija za unapređenje od strane Direktora Uprave za Ljudske resurse.	Unutar svake godine, izrađuje se jedna lista slobodnih mesta (odgovarajućih činova) zasnovano na predviđeni broj novih funkcija ili mogućih potreba reorganizacije, opšteg cirkulisanja ljudskih izvora i planirani odlazak u penziju za budući period.	Generalna Direkcija – Ljudski Resursi	Direktor Kadrovske Direkcije-
Opis zadataka i slobodnih mesta	Kriterijumi za slobodna mesta su godine po jednim činom, pozitivna ocenjivanja rada, obrazovanje i obuka.	Generalna Direkcija – Ljudski Resursi	Službenik Kadrovske Direkcije
Procedure unapređenja, većeg čina	Kada se stvore slobodna mesta, potrebno je odrediti detalje procedure dobijanja većeg čina, kao npr.: vrsta čina, vreme i mesto testiranja, odgovorne strukture, itd.	Generalna Direkcija – Ljudski Resursi	Direkcije za razvoj performanse i karijere
Objavlivanje konkursa i prikupljanje zahteva	Konkurs izdaje se na jednoj posebnoj strani unutrašnje mreže ili nekim drugim putem službenog obaveštavanja. Ova strana može biti i deo apliciranja zainteresovanih radnika, koja služi kao osnova za prikupljanje ovih aplikacija iz centralne strukture kadrovske odeljenja.	Generalna Direkcija – Ljudski Resursi	Direkcije za razvoj performanse i karijere
Razmatranje aplikacija	Direkcija Direkcije za razvoj performanse i karijere i Direkcija profesionalnih standarda, razmatra aplikacije policijskih službenika i ukoliko ne ispunjavaju određene kriterijume, neće biti uvrstani na listi policijskih službenika koji će biti podvrgnuti testu za dobijanje većeg čina. Diskvalifikovanim policijskim službenicima, saopštava se razlog zbog čega nisu obuhvaćeni tom listom.	Generalna Direkcija – Ljudski Resursi	Direkcije za razvoj performanse i karijere i Direkcija profesionalnih standarda
Priprema i razvijanje testova	Testove izrađuje Direkcija za performansu i razvoj karijere i odobrene od strane Generalnog Direktora, dok organizativne procedure razvijanja testiranja, pokriva Direkcije za razvoj performanse i karijere. Testiranje se vrši na određenom mestu i vremenu.	Generalna Direkcija	Direkcije za razvoj performanse i karijere
Uspešni kandidati	Nakon završetka testiranja, na osnovu ocenjivanja, formira se lista za svakog kandidata.	Komisija koja nadgleda proces	Direkcije za razvoj performanse i karijere
Obuka kandidata i dobijanje čina	Uspešni kandidati treba da pohađaju odgovarajuću obuku na osnovu redne liste. Nakon uspešnog završetka obuke, oni se raspoređuju na zadatku na osnovu pozicija. U slučaju da ne dobiju čin, oni ostaju da izvršavaju aktuelan zadatak i imaju pravo da ponovo konkurišu posle jene godine.	KAJB	KAJB - Uprava KP treninga
Administriranje rezultata testiranja	Rezultati testiranja se čuvaju u bazi podataka Direkcije za razvoj performanse i karijere za unapređenja i postupke u vezi time.	Direkcije za razvoj performanse i karijere	Direkcije za razvoj performanse i karijere